# AKTI I THEMELIMIT
# I SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUARA
# HEC MIRAKA

Sot, me datë 13.01.2025, (Trembedhjete, Janar, Dymije e njezete e pesë), Ortaku i vetëm themelues:

**KUARCI BLACE SHPK, me numër NIPT:** K24207608A, person juridik publik, organizuar dhe ekzistuese sipas Ligjeve te Republikes se Shqiperise me adrese te regjistuar, **Rruga "Teuta", Lagja Nr. 2, ndërtesa nr. 10, Hyrja 5, Pogradec, Shqipëri**, Vendosi themelimin e shoqerise **"HEC MIRAKA"** Shpk, permes ketij akti themelimi, me termat si me poshtë:

## NENI 1
## FORMA LIGJORE

Shoqeria eshte nje entitet ligjor shqiptar dhe ka formen ligjore te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar ("shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" ose "sh.p.k.').
Ortaket e shoqerise ("Ortaket") gezojne pergjegjesi te kufizuar deri ne limitin e kontributit perkates ne kapitalin e shoqerise.
Ortaket mund te kryejne ne baze te nje vendimi te Asamblese se Ortakeve, financime per llogari te shoqerise ne perpjesetim me pjesemarrjen e zoteruar ne kapital, mbulimin e humbjeve ashtu edhe per financime jo fitimprurese.
Shoqeria Tregtare **"HEC MIRAKA" Shpk,** rregullon poziten e saj juridike, marredheniet e themeluesve, te organeve te saj, llojin e Shoqerise, kohezgjatjen e veprimtarise se saj, marrdheniet me te punesuarit, duke u bazuar ne Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", te ndryshuar dhe dispozitat e tjera te legjislacionit shqiptar ne fuqi qe rregullojne marrdheniet e Shoqerive Tregtare.

## NENI 2
## EMRI DHE SELIA E SHOQERISE

Shoqeria do te paraqitet ne qarkullimin juridiko - civil me emertimin e saj "HEC MIRAKA" SH.P.K.
Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen Rruga "Teuta", Lagja Nr. 2, ndërtesa nr. 10, Hyrja 5, Pogradec, Shqipëri.
Shoqëria mund të hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.
Shoqëria do të ketë vulën e saj.

## NENI 3
## OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria ka per objekt veprimtarie:

- Shfrytezimin dhe Administrimi i Hidrocentralit MIRAKA, me kapacitet prodhues 0.613 MW, e ndertuar në përroin e Lugjeve dhe Mirakes, në Bashkinë Librazhd, Qarku Elbasan,

KUARCI BLACE SH.P.K POGRADEC

me qëllim prodhimin, furnizimin, transmetimin, shperndarjen, eksportimin dhe shitjen e energjise elektrike sipas Kontrates së nënshkruar me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë Nr. 1725 Rep, Nr. 767/3 Kol, datë 19 Korrik 2017.

- Shitja e elektricitetit te prodhur ne Shqiperi dhe jashte saj.

- Blerje dhe shitje te paisjeve per ndertim HEC-i (tubacione celiku, turbina, shtylla betoni aksesore te tjera etj, brenda dhe jashte vendit).

- Shoqëria do të kryejë edhe aktivitete të tjera shtesë, me qëllim përmbushjen e veprimtarisë së saj kryesore në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi.

## NENI 4
## KAPITALI THEMELTAR

Kapitali fillestar i investuar nga Ortaket, perben bazen e krijimit te fondit themeltar te mjeteve te xhiros. Administratori i dorezon Ortakeve dokumentin vertetues per sasite e shumave te derdhura ne fazen e themelimit.

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga kontributi ne para i Ortakut themelues.
Kontributi ne para do te kete vleren prej 100 000 (Njeqind mije) leke i ndare ne 1 (nje) kuote e zoteruar nga Ortaku i vetem.

## NENI 5
## ORTAKU I SHOQERISE DHE KUOTAT E ZOTERUARA PREJ TIJ

Ortaku i vetem i shoqerise tregtare "HEC MIRAKA" SHPK eshte **KUARCI BLACE SHPK, me numër NIPT:** K24207608A, i zotëron kuoten ne shoqeri si me poshte:

**KUARCI BLACE SHPK**, ne cilesine e Ortakut themelues zoteron 100% te vleres se kapitalit themeltar te barabarte me nje kuote me vlere te pergjithshme prej 100 000 (Njeqind mije) leke.

Kapitali themeltar eshte investuarr nga ortaku themelues ne total.

## NENI 6
## ORGANET DREJTUESE

Referuar Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese te shoqerise jane:

- Asambleja e Pergjithshme e ortakut të vetem – si organi me i larte vendimmarrës.
- Administratori.

## NENI 7
## ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Organi themelor i shoqerise eshte Asambleja e Pergjithshme.
Asamblea e Pergjithshme merr vendime te cilat kerkojne 100 % e votave ne rastet e meposhtme:

- ndryshimet e statutit;
- zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
- shperndarjen e fitimeve;
- raste te tjera te parashikuara nga ligji ose statuti;

Per rastet e tjera ajo vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres si me poshte:

- miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
- percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- emerimin e shkarkimin e administratoreve;
- emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- percaktimin e shperblimeve per administratoret, likuiduesit dhe ekspertet kontabel te autorizuar.
- mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- raste te tjera te parashikuara nga ligji ose statute.

**NENI 8**
**ADMINISTRATORI**

Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, nuk mund te jete me i gjate se 3 vjet, me te drejte riperteritjeje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Statuti mund te caktoje rregulla te posacme per emerimin e administratoreve.

Administator i Shoqerise do te emerohet si me poshtë:

**Z. ARDIT JAKUPLLARI,** shtetas Shqiptar, lindur ne Fshatin Remenj, Pogradec, i datëlindjes 27.02.1994 dhe me vendbanim në Fshatin Remenj, Pogradec, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar, mbajtes **i** Kartes se Identittetit me Nr. **033339178 dhe ID J40227089G.**

Shoqeria do te perfaqesohet perpara cdo organi administrativ, gjyqesor, apo cdo entiteti tjeter publik apo privat dhe ne marredhenie me te tretet nga Administratori i shoqerise, i cili i ushtron te drejtat e tij ne perputhje me Statutin e shoqerise dhe me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

**NENI 9**
**TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ADMINISTRATORIT**

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- perfaqesoje shoqerine tregtare;
- kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;

- pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shpemdarjen e fitimeve, te paraqese keto dokumente perpara asamblesc se pergjithshme per miratim;
- krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siy parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;
- raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posayme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Per aq sa eshte e lejueshme dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, Administratori ka te drejte te kryeje veprimtari tregtarc ne emer dhe per llogari te shoqerise, pa qenë nevoja te marre paraprakisht pelqimin e Asamblese se Pergjithshme, nese: keto veprime jane ne perputhje me objektin, veprimtarine dhe politikat e shoqerise.
Asambleja e Pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme. Statuti apo marreveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte. Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

## NENI 10
## FITIMI DHE KALIMI I KUOTAVE

Kuotat e kapitalit të shoqërisë fitohen apo kalohen nëpërmjet:
a. Kontributin në kapitalin e shoqërisë.
b. Shitblerjes.
c. Trashëgimisë.
d. Dhurimit.
e. Cdo mënyrë tjetër e parashikuar në ligj.

## NENI 11
## HYRJA NE FUQI

Ky Akt Themelim hyn ne fuqi pas miratimit dhe regjistrimit te Shoqerise ne regjistrin tregtar prane Qendres Kombetare te Biznesit.

Ky Akt Themelim perpilohet ne tre kopje me nga katër, me vlerë te njejtë ne gjuhen Shqipe, e nenshkruhet pa verejtje nga ortaku themelues.

**ORTAKU THEMELUES I VETËM**
**SHOQËRIA, KUARCI BLACE SHPK**

**ADMINISTRATOR**
**ARDIT JAKUPLLARI**